

VENDIM
Nr.47, datë 14.10.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Hilmi Dakli	Anëtar i	"	"
Zija Vuçi	Anëtar i	"	"
Franc Jakova	Anëtar i	"	"
Hajredin Fuga	Anëtar i	"	"
Kristofor Peçi	Anëtar i	"	"
Kujtim Puto	Anëtar i	"	"
Sokol Sadushi	Anëtar i	"	"
Alfred Karamuço	Anëtar i	"	"

më datë 5.10.1998 me sekretare Arta Palushi mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen që i përket:

KËRKUES: Enti i banesave Durrës, i përfaqësuar nga Albert Jakova

SUBJEKTI I INTERESUAR: Zydi Harizi i përfaqësuar nga avokat Ermir Dobiani

OBJEKTI: Shpallja antikushtetues e vendimit nr.653, datë 15.05.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesit të kërkuarit të subjektit të interesuar;

VËREN:

Kërkesa nuk është paraqitur nga Enti i Banesave Durrës, por nga avokati Aldo Zadrime, i cili nuk ka pasur tanger për të përfaqësuar Entin para Gjykatës Kushtetuese.

Përfaqësuesi i Entit të Banesave Durrës shpjegoi para Gjykatës Kushtetuese së avokatit i ishte dhënë prokurë vetëm për të përfaqësuar këtë institucion në Gjykatën e Kasacionit dhe se për kërkesën drejtuar në Gjykatën Kushtetuese drejtori i Entit nuk kishte asnjë dijeni.

Në këto kushte, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është drejtuar nga subjekti që legjitimohej sipas dispozitave kushtetuese e për pasojë duhet të rrëzohet.

Për këto arsye: dhe në mbështetje të nenin 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", Gjykata Kushtetuese njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.